



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBETAR RREGULLATOR

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në nenin 9, të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 34/2016, datë 28.04.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU shpall konkurim për vend të lirë pune, në pozicionin:

- ***Specialist i analizës ekonomiko financiare, në sektorin e Ekonomik dhe Tarifave (kategoria III-b)***

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore për largim nga puna, për shkak të shkeljeve disiplinore dhe cenim të rregullave të etikës;
- të mos ketë lidhje familjare me anëtarët e KKRR, apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët ka lidhje hierarkie;
- të ketë kryer studimet e larta në degën Ekonomi ose Finance, të nivelit DND;
- të ketë përvojë pune në profesion jo me pak se 3 vjet;
- të ketë aftësi të mira të punës në grup;
- të zotërojë shumë mirë në të folur dhe shkruar gjuhën angleze, të vërtetuara.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 25.03. 2020 ora 16.30 në Zyrën e protokollit të ERRU, në adresën Blv. "Bajram Curri", Rr. "Viktor Eftimiu", ish godina e KESH, kati IV, Tiranë këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim,
- CV personale me fotografi,
- Diplomë të shkollës së lartë (fotokopje e noterizuar),
- Listën e notave (fotokopje e noterizuar),
- Fotokopje të noterizuar te librezes së punës,
- Dëshmi penaliteti,
- Raport mjeksor për aftësi shëndëtsore,
- Dokument që vërteton njohjen e gjuhëve të huaja,
- Dokumenta të tjera kualifikimi,
- Referenca për përvojat e mëparshme në punë,
- Dokument indentifikimi (fotokopje)